V E N D I M
Nr.303, datë 1.7.1999

PËR KRIJIMIN E SISTEMIT TË AKREDITIMIT NË ARSIMIN E LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sistemi i akreditimit ka për funksion drejtimin dhe kryerjen e procesit të akreditimit në shkollat e larta. Institucionet e sistemit të akredimit të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë janë Këshilli i Akreditimit dhe Agjencia e Akreditimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

2. Këshilli i Akreditimit është organ kolegjial, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Statuti i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ai përbëhet nga 11 vetë, personalitete në fushën e arsimit të lartë, të shkencës dhe të ekonomisë shqiptare, me tituj shkencorë, që provojnë përvojën dhe kompetencën akademike dhe shkencore. Anëtarë të Këshillit të Akreditimit janë gjashtë përfaqësues të sistemit të arsimit të lartë, dy përfaqësues të sistemit të institucioneve shkencore, dy përfaqësues të ekonomisë shqiptare dhe një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kryetari i Këshillit të Akreditimit shpërblehet çdo muaj me 40 për qind të rrogës së profesorit, kurse anëtarët me 30 për qind të rrogës së profesorit.

3. Agjencia e akreditimit është institucion publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Numri i punonjësve të kësaj agjencie është brenda numrit të punonjësve të planifikuar për vitin 1999, për sistemin e arsimit dhe të shkencës dhe buxheti i saj për vitin 1999 mbulohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe shkencës. Për kryerjen e funksioneve Agjencia angazhon edhe punonjës të jashtëm.

Agjencia e Akreditimit i ka zyrat në mjediset e Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor dhe Teknik.

4. Trajtimi financiar i drejtorit të Agjencisë së Akreditimit barazohet me klasën B4 të lidhjes nr.1 "Renditja e funksioneve sipas klasifikimit", ndërsa specialistëve me klazën IX të lidhjes II,M "Pagë bazë sipas klasave për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, RTV-së, ATSH-së dhe prefekturave".

5. Këshilli i Akreditimit miraton kriteret e vlerësimit të brendshëm, programor dhe institucional, të hartuara nga Agjencia e Akreditimit, miraton kërkesën e shkollës së lartë për vlerësimin përkatës, si dhe periudhën gjatë së cilës duhet të kryhet ky vlerësim, vendos për rezultatin përfundimtar të vlerësimit, sipas raportit të hartuar nga Agjencia e Akreditimit. Rezultati përfundimtar quhet pozitiv, kur plotësohen kriteret e caktuara. Në të kundërt quhet negativ. Këtë rezultat këshilli ia paraqet për vendim Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Agjencia e Akreditimit harton kriteret e vlerësimit të programeve dhe të institucioneve, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit të Akreditimit dhe ua bën të njohura të gjitha shkollave të larta. Kjo agjenci regjistron kërkesat e shkollave të larta për vlerësim institucional. Ajo, gjithashtu, kryen vlerësimin e programeve dhe vlerësimin institucional. Rezultatet e vlerësimit ia paraqet Këshillit të Akrditimit.

7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pas shqyrtimit të raportit të dhënë nga Këshilli i Akrditimit, nëse ai është negativ, merr vendimin për mbylljen ose jo të kurseve ekzistuese të studimit ose paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave mbylljen ose jo të shkollave ekzistuese të larta publike apo të strukturave të tyre përbërëse. Studentëve të këtyre kurseve apo shkollave u krijohet mundësia për vazhdimin e kursit të ngjashëm në një shkollë tjetër të lartë në rast se është e mundur një e tillë. Kur nuk gjenden mundësi që studentët ekzistues të përfundojnë studimet, këto kurse lejohen të funksionojnë vetëm vitet që kanë mbetur për të përfunduar ciklin.

Në rastin e arismit të lartë jopublik, në qoftë se raporti i Këshillit të Akreditimit është negativ, kjo ministri merr vendim për mosnjohjen e kurseve ekzistuese të studimit ose i propozon Këshillit të Ministrave mosnjohjen e shkollës.

Këto procedura janë të vlefshme edhe për kurset e studimit në shkollat pasuniversitare.

Në rastin e vlerësimeve pozitive, Ministri i Arsimit dhe Shkencës shpall nivelin e diplomës.

8. Procedura e vlerësimit kryhet kur vetë shkolla kërkon të vlerësohet ose kur këtë gjë e kërkon Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Një degë apo shkollë e lartë publike mund të funksionojë pa u akredituar për një periudhë jo më shumë se 4 vjet. Në rast se shkolla nuk e kërkon vlerësimin brenda kësaj periudhe, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet t'ia kërkojë këtë vlerësim Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit.

10. Shkollat e larta jopublike marrin përsipër të gjitha shpenzimet financiare për vlerësimin dhe akreditimin e tyre, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse.

11. Agjencisë së Akreditimit, që nga dita e krijimit në përputhje me këtë vendim, i jepet një afat kohor 6-mujor për hartimin e kritereve të vlerësimit të shkollave të larta.

12. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko